



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësi/orig. Org Jednica Org Unit	A-242
Nr i Fajteve Br Stranica No Pages	-04-
Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	6898-2/22
Data: Datum: Date:	17.05.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	12.05.2023
REFERENC-Ë:	6898-2/22 - ZSP- 2023
PËR/ZA/TO:	„Alba Group” sh.p.k., Llapllasellë, K. Graçanicë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Z. Servet SPAHIU, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL-së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore, Shkarkim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investiv shtesë, për shkarkim të ujërave të ndorura, me Nr. të protokollit: 6898-2/22, parashtruar nga „Alba Group” sh.p.k., Llapllasellë K.Graçanicë dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

L.U.

Datë: 12.05.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa dhe dokumentacioni investivo teknik shtesë për palën „Alba Group” Sh.p.k. **K. Graçanicë**, me Nr.prot. 6898-2/22, datë 20.02.2023, për **Leje Ujore** për shkarkimin e ujërave nga betonjera, në pikën me koordinata (X= 7 510 967 ; X= 4 714 200) ne ngastren P-73414042-01889-0, nga baza për prodhimin e betonit, me kushtet si në vijim:

1. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv, për betonjerë;
2. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
3. Analiza dhe përcaktimi i parametrave standard e projektues, kualitativ dhe kuantitativ (temperatura, ph, SHBO₅, SHKO, sasia materieve te suspenduara, baktereve e ngjashëm) të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, paratrajtimi për specifikat e recipientit - kanalizimi publik (ITUZ), duhet prezantuar në MMPHI, ;

Faqe 2 nga 4

Adresa: ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558
<http://www.ks.gov.net/mmph> E-mail: zsp.mmph@ks.gov.net



4. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe llumit dhe ato të shkarkimit, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;
5. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit të dëmeve eventuale mjedisit ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitoj dhe t'i kompensoj;
6. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit sipas destinimit të veçant Rezultatet e monitorimit të raportohen në MMPHI/ARPL çdo gjasht muaj;
7. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin ujërave të ndotura do të caktohet me vendim të posaçëm, në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas U.A. MMPH –Nr. 02/2022 për kushtet, mënyra, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor”
8. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujqore nuk mund t'u barten personave të tretë pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujqore;
9. Për vazhdimin e Lejes Ujqore bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujqore;
10. Validiteti i Lejes Ujqore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: Certifikata e regjistrimit të biznesit të “ALBA GROUP” (810829864); Akvendim i lëshuar nga K, Graçanicë për kryerjen e veprimtarisë prodhim i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim; datë 18.01.2018; Vendim pëlqim mjedisor , me Nr. 20/1398/1-ZSP-/126/20, datë 19.05.2020; Pëlqim mjedisorë. Me nr 21/3544/1-ZSP- /21, datë 28.10.2021 për vinë e dytë; Plani i situacionit me përpjesë 1:1500, ashtu siq kerkohet me U.A. nr 03/2018 për procedurat per leje ujqore, hartuar, nënshkruar dhe vulosur nga person juridik i licencuar “Gjeodeti”, me Nr. lic. 61; Kopje plani për parcelën, me P-73414042-01889-0; Certifikata e Pronesisë; Skema e projektit të betonjeres; Dokumentacion i kompanisë hartuese: Cetifikata e regjistrimit të biznesit N.SH. “ING –CONSULT”; Diplomë e hartuesit, inxhinier i hidroteknikes ; certifikata e hartuesit , Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë; CD-ja ;Pagesat për tarifatat gjate aplikimit për K.U.; PU; L.U. Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, shikimit në vend, me 28.12.2022, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujqore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 6898-2/22 -ZSP- 2023, Datë: 12.05.2023

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Graçanicë;
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Servet SPAHIU

